Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Dokumentat standarde të tenderit

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.
nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 7/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër

nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*

c. *Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;*

e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A me kod III.1.C, së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe Licensën Profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet anatomike dhe mbetjet farmaceutike (orientim respektivisht ne kodet 18 01 02 dhe 18 01 09 te Katalogut shqiptar te mbetjeve) ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim

2. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore minimalisht tipi B me kod III.1.B së bashku me Akt Miratimin përkatës, dhe Liçencën Profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet e mprehta, infektive dhe te tjera (orientim respektivisht ne kodet 18 01 01, 18 01 03, 18 01 04 te Katalogut shqiptar te mbetjeve), ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të vërtetohet xhiroja për vitet 2016, 2017 dhe 2018 në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2016, 2017 dhe 2018
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument lëshuar nga administrata lokale që vërteton se nuk është debitor për shlyerjen e detyrimeve për taksat vendore për vitin 2019.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar me sukses, gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave, shërbime të mëparshme të ngjashme (shërbime të kryera nepermjet lejeve dhe licencave të paraqitura nga OE për kualifikim), në vlerën jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion. Si dëshmi e përvojës së mëparshme operatori duhet të paraqesë:
 - a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një Ent Publik kërkohet Kontrata dhe Vërtetime të lëshuara nga enti publik për realizimin e shërbimit ose/dhe fatura tatimore shitje ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. Operatori pjesëmarrës gjatë periudhës Janar 2019 e vijim duhet të ketë një punësim mujor prej të paktën 10 punonjës (duke përfshirë këtu dhe stafin menaxherial dhe teknik), kjo e vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme, dhe

Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.
3. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin se ka të punësuar dhe rregjistruar në listëpagesa nga Janar 2019 e në vijim:

Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi dhe/ose Inxhinier Agromjedisi dhe/ose Inxhinier Kimik.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për stafin me sipër:

Librezë pune (përkatëse)

CV përkatëse

Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

Diplome

4. Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit”
- BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

Në zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018, të gjitha certifikatat e cilësisë duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilët janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

5. Për transportin e mbetjeve, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht 3 (tre) automjete të izoluar hermetikisht, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjen dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore (në përputhje me pika 8.8/c dhe Shtojces nr.4 të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni: 9.3.3 ‘Automjetet/anijet e grumbullimit’). Operatori duhet të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qera të mjetit.

- Për të vërtetuar këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për automjetin në pronësi: *Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.*

Për automjetet që nuk janë në pronësi: *Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.*

6. Operatori ekonomik duhet të paraqese një kontratë aktive, të lidhur te pakten per vitin 2020 me një Landfill te licensuar, për depozitimin e produktit final qe del nga asgjësimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes se ofertave.

7. Te vendose ne dispozicion te spitalit, kontenitore sipas standarteve te OBSH dhe VKM 798 date 20.09.2010 “Mbi mbetjet spitalore”. Per permbushjen e ketij kriteri OE duhet te paraqesin: fature blerje ose zhdoganimi dhe Certifikaten e Tipit te ambalazhit sipas rregullave ADR (document qe verteton se ambalazhi eshte ne perputhje me normat e transportit te mallrave te rrezikshme), per kontenitore te kapaciteteve te meposhtme:

Mbetje infektive prerese dhe shpuese – duke filluar nga minimumi 0.6 L deri ne maksimumi 6.5L

Mbetje infektive – minimumi 40L deri ne maksimumi 60L

Mbetje anatomike – minimumi 40L

Mbetje farmaceutike – minimumi 20L

Gjithashtu OE duhet të paraqesin mostra për secilin kontenitor (sipas permasave) shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar me sipër.

Mostrat duhet të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

8. Dokument që verteton se OE ka në pronësi peshore të kalibruar, vertetuar kjo me faturë tatimore blerje, dokument për kalibrimin e mjeteve peshuese dhe foto të peshores, për të siguruar zbatimin e VKM Nr. 371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorezimit të tyre”.

9. OE duhet të paraqesin vetedeklarim se kanë gjendje të pakten dy frigorifere ngjirës të cilët do të instalohen në ambientet e SUT për ruajtjen e mbetjeve anatomike deri në momentin e transportimit deri në inceneritor. Kapaciteti i frigorifereve duhet të jetë jo më pak se 40L (frigoriferet duhet të mbajnë të pakten një kosh 40L). Për të vertetuar këtë, OE duhet të paraqesin vetedeklarim me shkrim.

10. Dokument që verteton se ka në pronësi ose me qera implant incenerimi dhe autoklavimi të evidentuar në Leje Mjedisore, me kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar sasinë e mbetjeve spitalore objekt i këtij prokurimi. Bazuar në eksperiencën e AK, kërkohej që kapaciteti i implantit të incenerimit të jetë jo më pak se 10 kg/ditë dhe kapaciteti i imiantit të autoklavimit të jetë jo më pak se 160 kg/ditë.

Për të provuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët duhet të paraqesin:

- a. Dokument që provon pronësinë apo disponimin me qera në një nga menyrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qeraje, faturë blerje ose zhdoganimi)
- b. Kartën teknologjike të implantit/implanteve
- c. Deklaratën e Konformitetit CE të implantit/implanteve të leshuar nga kompania prodhuese.

11. Për të vertetuar që OE i plotësojnë kërkesat në dokumentat e tenderit, duhet që të paraqiten kopje të kartave të identitetit me ID përkatës për çdo person sipas shtojcës Nr. 7 “DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME”. Kopjet e kartave nevojiten për të kontrolluar certifikatat gjyqësore online sipas legjislacionit dhe udhëzimeve të APP.

KVO i Autoritetit Kontraktore para shpalljes së fituesit dhe para se të vendose për kualifikimin ose jo të operatorit ekonomik, do të verifikojë në vend duke punuar implantet përkatëse për këtë qellim dhe pajisjet/makinëritë që nevojiten për kryerjen e shërbimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet të asgjësohen në një impiant për inçinerim i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas përcaktimeve të mëposhtme:

Në **mbështetje të Ligjit** Nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjin Nr. 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”, Ligjit Nr. 9010 datë 13.02.2003 “Administrimit Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”, Ligjit Nr. 9537 datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore”.

Mbetje me KODIN: KODI 18 01 01, 18 01 03, 18 01 04 sipas Katalogut shqiptar të mbetjeve, ose ekuivalente sipas **VKM 798, Date 29.09.2010** do të asgjësohen sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”: **Shtojca 3)** “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, **Pika 2)** Me autoklavim, **Shtojca 5)** “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”. Kjo metodë e mbështetur në Udhëzimin Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bera në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni 7.1, Tabela 1.

Mbetjet me KODIN 18 01 02 dhe 18 01 09 ose ekuivalente sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, do të asgjësohen sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” **Shtojca 3)** “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, **Pika 1)** “Incenerim”, **Shtojca 5)** “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”. Kjo metodë e mbështetur në Udhëzimin Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bera në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”,

Seksioni 7.1, Tabela 1.

2. Tërheqja e mbetjeve do të behet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Mbetjet duhet të merren nga kontraktuesi pranë Autoritetit Kontraktor me mjete të posacme në pronësi të sipërmarrësit dhe me abalazhimin përkatës në përputhje me standartet për mbetjet e rrezikshme spitalore duke respektuar standartin sipas VKM 798, dt.29.09.2010, “ *Per administrimin e mbetjeve spitalore*” dhe Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore”.
2. “Asgjesimi duhet të realizohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja), si dhe Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore.”.
4. Qeskat dhe kontenerët duhet të mbulohen nga sipërmaresi dhe në rastin kur janë plastike shumë përdorimëshe, duhet të sigurohet larja dhe dizinfektimi i tyre në çdo ripërdorim. Për arsye të hapësirave fizike dhe për një menaxhim sa më të mirë të shërbimit, konteneret duhet të jenë me kapacitet si vijon:
Mbetje infektive prerese dhe shpuese – minimumi 0.6L deri në maksimumi 6.5L (L= Litra)
Mbetje infektive – minimumi 40L deri në maksimumi 60L
Mbetje anatomike – minimumi 40L
Mbetje farmaceutike – minimumi 20L
Sipas përcaktimeve të bëra në VKM 798, dt.29.09.2010 “*Per administrimin e mbetjeve spitalore*”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “*Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore*”, të gjithë konteneret që përdoren nga spitali duhet të merren nga firma dhe të behet dezinfektimi i tyre prej saj.
5. Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabelë sinjalizuese të cilat tregojnë *prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambjentin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor*, në bazë të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.
6. Operatori ekonomik dhe Përfaqësuesit e Spitalit për çdo dorëzim mbetjesh spitalore tek operatori për asgjësim do të mbajnë “Dokumentin e dorëzimit të mbetjeve të Rrezikshme” sipas VKM Nr. 371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”. Saktësia e plotësimit të dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, do të sigurohet nëpërmjet dokumentit të peshimit dhe Operatori duhet të mbajë evidencat përkatëse si dhe të dhënat e ciklit të perpunimit për çdo asgjësim.
7. Mbetjet e vecanta të vendosura në ambalazh do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve nga një peshorë, e cila duhet të disponohet nga Operatori Ekonomik. Mbas çdo tërheqje të mbetjeve, do të hartohet proces verbal për sasinë e peshuar në tre kopje dhe

nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor. Dy kopje mbahen nga AK dhe një kopje e merr kontraktuesi. Pesha e mbeturinave të rrezikshme spitalore do të llogaritet neto duke zbritur peshën e ambalazhit.

8. Operatori ekonomik, duhet të instalojë të paktën dy frigorifere në ambientet e SUT te pershtatshëm për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme të buta dhe të ngurta, deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit. Te sigurohet dezinfektimi i mirë i frigorifereve dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet.

9. Tërheqja e mbetjeve spitalore të bëhet çdo ditë, çdo dy ditë e çdo javë, në varësi të fluksit të mbetjeve por dhe sigurimit të kushteve frigoriferike. Operatori ekonomik kontraktues, të caktojë një person kontakti që do të mbajë lidhje me SUT për çdo problem dhe emergjencë.

10. Bazuar në eksperiencën e vitit 2018-2019, sasia mesatare e mbetjeve spitalore është rreth **170 kg në ditë ose 62,050 kg për 365 ditë**.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër <u>Minimumi 4</u>		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Sqarim:

Ak nuk mund të parashikojë sakte nevojat që do të lindin për kryerjen e këtij shërbimi për një periudhë 24 mujore. Duke u bazuar në Marrëveshjet kuadër të vitit 2019, parashikohet që të

lidhen minimumi 4 kontrata per sherbimin e kerkuar sipas buxhetit te SUT per vitin 2020 dhe atij te vitit 2021.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT”

Dokumentat standarde të tenderit

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga data e nënshkrimit të Marrveshjes Kuader

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT” per nje periudhe 24 mujore ose 731 dite te perllogaritura sipas kalendarit per vitin 2020 dhe vitin 2021.

Detyrat: OE do te marin persiper te kryejne sherbimin e kerkuar per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore per Spitalin Universitar te Traumes sipas legjislacionit ne fuqi dhe sipas specifikimeve teknike dhe kushteve te kerkuara ne keto dokumenta tenderi.

Shpërndarja: Ak do te njoftoje OE te suksesshem per lidhjen e kontrates se sherbimit sa here qe te kete nevojë dhe brenda fondit limit te parashikuar per kete procedure prokurimi.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Universitar i Traumes

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të

Dokumentat standarde të tenderit

shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Dokumentat standarde të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premteton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë

kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

